

# RELACION TEKNIK

## Objekti “Sistemim asfaltim rrugët e Rajonit Qendër – Perëndim (Tiranë)”


### PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Projekt – zbatimi i objektit “Sistemim asfaltim rrugët e Rajonit Qendër – Perëndim (Tiranë)” është hartuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ndërhyrja do të bëhet në segmentin Instituti Bujqësor – Kamëz (qendër). Ky segment është pjesë e aksit rrugor Tiranë – Shkodër i cili është shumë i rëndësishëm pasi shërben për lidhjen e kryeqytetit me veriun e vendit.



Numri më i madh i mjeteve të zonës së veriut që lëvizin drejt Tiranës kalojnë në këtë segment rrugor.

Ky segment rrugor ku do të ndërhyet ka një gjatësi prej rreth 2.8 km me dy karrexhata me trafikndarës, me gjerësi të shtresës asfaltike 7 m në të dy senset e lëvizjes.



Rruga kalon nëpër një zonë të dendur urbane dhe i nënshtrohet një trafiku të rënduar ku një pjesë të madhe e zë trafiku i mjeteve të rënda.

Shtresat asfaltike janë të dëmtuara me gropëzime, çedime, rrjetëzime etj.

Shtresa e asfaltotapetit është e konsumuar dhe e rrjetëzuar në të gjithë sipërfaqen dhe për të gjithë këtë gjatësi. Shtresa e binderit është e dëmtuar në pothuaj 40% të sipërfaqes së asfaltuar, dëmtim ky që vazhdon edhe në shtresën e stabilizantit në rreth 30% të sipërfaqes totale.

Paraprakisht, theksojmë se paketa e shtresave është ruajtur si ajo ekzistuesja, 4cm asfaltobeton dhe 6cm binder.

Ndërhyrja parashikon skarifikimin (frezimin) e të gjithë shtresës së tapetit dhe shtresën e binderit në rreth 40% të sipërfaqes totale. Gjithsesi pas heqjes së shtresës së tapetit do të përcaktohet saktë sipërfaqja dhe thellësia e saktë e ndërhyrjes në shtresën e binderit dhe nënshtresat e tjera. Pas frezimit do të vazhdohet me profilimin e shtresës së stabilizantit 15cm, të binderit me trashësi 6cm dhe asfaltimin e shtresës së tapetit me trashësi 4cm.

Më tej sinjalistika horizontale e vijëzimit gjatësor me gjerësi 15cm dhe shenjave të trafikut do të bëhet me bojë termoplastike sprajt.

Planin i menaxhimit të trafikut do të jetë i ndryshueshëm sipas avancimit të punimeve që do të thotë që rrugët alternative për devijimin e trafikut do të ndryshojnë në vazhdimësi deri në përfundimin e punimeve. Ai do të përgatitet nga kontraktori në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe do të miratohet nga Autoriteti Kontraktor në Bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë.

Grupi i punës: